

UÇK, *Lista e deshmoreve...*, FDH-36427; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Din (Adem) Temaj

(18.10.1946, shqiptar nga Kushnini/Kušnin, komuna e Prizrenit/Prizren, bujk, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Dini aderoi në UÇK në vitin 1998. Për detyrë e kishte furnizimin e ushtarëve me ushqime dhe armatime. Meqë jetonte pranë kufirit dhe e njihje mirë terrenin, ai u shërbente si udhërrëfyes ushtarëve të UÇK-së, të cilët kalonin matanë kufirit. Herën e fundit e shihnin të gjallë më **18.08.1998**, kur, sipas urdhrut, u nis që ta kalonte bjeshkën *Pashtrik/Paštrik*. Familjarët nuk kanë ende kurrfarë njohuri për të. Zhdukja e tij është regjistruar nga KNKK-ja dhe lënda e tij e mban numrin BLG-804534-01.

Burimet: deklaratat Z.T, FDH-34782; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Marijan (Ndreca) Domgjonaj

(1.06.1942, shqiptar nga Gražhdaniku/Graždanik, komuna e Prizrenit/Prizren, tetë fëmijë)

Në datën **30.08.1998**, rreth orës 10:30, katër burrat e panjohur e kanë marrë Marijanin me dhunë në **Gražhdanik/Graždanik** dhe e kanë futur në makinë të tipit *Golf*, pa targat e regjistrimit. E çuan në drejtim të panjohur. Pas dhjetë ditësh, më 9.09.1998, trupin e tij të groposur e kishin gjetur në Leskovec/Leskovac. Ishte i ekzekutuar me një plumb në kokë.

Burimet: deklaratat A.S, FDH-34800; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 140, 913.

Kadisha (Abaz Gashi) Berisha

(1925, shqiptare nga Jeshkova/Ješkovo, komuna e Prizrenit/Prizren, amvise, tetë fëmijë)

Në orët e hershme të mëngjesit, më **1.09.1998**, UJ dhe policia serbe e kanë sulmuar **Jeshkovën/Ješkovo**, Lezin/Lez dhe fshatrat përreth. Shtabi i UÇK-së gjendej në shtëpinë e Naser Shales. Shumica e banor-

ëve të Jeshkovës/Ješkovo u strehua në pyllin e afërt. Kadisha e moshuar, e braktisi shtëpinë, së bashku me djalin Besimin, vajzën Kadishen, të rejën Lumturijen dhe nipërit. Kur, më vonë, pushuan bombardimet, plakja Kadishe u kthye në fshat për tu furnizuar me ushqime. U vonua, dhe e reja u nis për ta kërkuar. E ka gjetur të plagosur në shtëpi, e cila ishte në flakë nga eksplozimi i predhës. E reja e mori vjehrrën dhe dolën në oborr për tu larguar, por forcat serbe sërish e filluan bombardimin. E reja iku me vrap në pyll, duke e lënë plakën pas vete. Pas tërheqjes së forcave serbe, disa banorë dhe pjesëtarë të forcave të UÇK-së i kanë zbuluar mbetjet mortore të Kadishes. I varrosën në varrezat e Jeshkovës/Ješkovo më 5.09.1998.

Burimet: deklaratat L.B, FDH-20574; deklaratat N.S, FDH-2547; deklaratat F.B, FDH-2545.

Fatime (Aziz Hazeraj) Shala

(20.07.1944, shqiptare nga Jeshkova/Ješkovo, komuna e Prizrenit/Prizren, amvise, katër fëmijë)

Myrvete (Shemsi Kryeziu) Shala

(24.12.1968, shqiptare nga Jeshkova/Ješkovo, komuna e Prizrenit/Prizren, amvise, dy fëmijë)

Kur forcat serbe e nisën bombardimin e Jeshkovës/Ješkovo më 1.09.1998, Fatimja dhe e reja Myrvetja u strehuan në bodrumin e kushëririt Daut Shales. Përveç tyre, në bodrum ishin strehuar edhe familjarë dhe banorë të tjerë. Rreth orës 15:00 [**1.09.1998**], ata dëgjuan se forcat serbe kishin nisur depërtimin në fshat. Dolën jashtë dhe u nisën drejt Hoçës së Qytetit/Hoča Zagradaska, duke e marr rrugën pranë lumit *Gjeqi*. Në qendër të fshatit [**Jeshkovë/Ješkovo**], një predhë ka eksploduar në afërsi të Myrvetes dhe Fatimes. Myrvetja ka mbetur e vdekur në vend, përderisa ciflat e predhës e kanë plagosur rëndë Fatimen në stomak. Ashtu e plagosur, ajo e ka vazhduar rrugën për afro 200 - 300 metra dhe, më pas, nuk mund të ecte më. Në datën 5.09.1998, disa banorë dhe pjesëtarë të UÇK-së i kanë gjetur trupat e Fatimes dhe Myrvetes. I varrosën në varrezat e fshatit.

Burimet: deklaratat N.S, FDH-20575; deklaratat F.B, FDH-2545; deklaratat N.S, FDH-2547.